




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



UDHËZUES PËR PËRPILIMIN E RAPORTIT NARRATIV DHE FINANCIAR

1. Përfituesit e subvencioneve pas realizimit të projektit të mbështetur janë të obliguar të bëjnë përmbylljen e projektit;
2. Për përmbylljen e projektit fillimisht dorëzohen/ protokollohen dokumentet si në vijim:
 - a. Raporti narrativ:
 - i. duhet të përmbajë informata rreth ekzekutimit të projektit sipas kërkesës së aprovuar dhe mbështetur;
 - b. Raporti financiar:
 - i. duhet të përmbajë informata të detajuara mbi menaxhimin e të hyrave financiare të subvencionuara për realizimin e projektit;
 - ii. dëshmitë financiare përkitazi me raportin.
3. Zyrtari përkatës kontrollon raportin përmbyllës nëse:
 - a. është realizuar apo jo projekti sipas kërkesës dhe kontratës me palën;
 - b. janë realizuar apo jo shpenzimet sipas kërkesës dhe kontratës mbështetur në këto kritere:
 - i. Për shumat deri në 50€ dorëzohet kuponi me datë, me numër të kuponit, me numër fiskal apo numër të regjistrimit të biznesit, me vulë dhe me nënshkrim të pranuesit dhe të marrësit;
 - ii. Për pagesat e personave deri në 100€ duhet vetëm kontrata e nënshkruar nga të dy palët apo kontrata kolektive e vulosur dhe kopja e letërnjoftimit të përfituesit;
 - iii. Për pagesat e personave mbi 100€ duhet kontrata, transferi bankar dhe kopja e letërnjoftimit të përfituesit;
 - iv. Për faturat mbi 500€, përveç faturës me datë, numër të regjistrimit të biznesit dhe numër fiskal, duhet kontrata dhe transferi bankar të nënshkruara nga blerësi dhe shitësi;
 - v. Të gjithë kuponët dhe faturat duhet të jenë origjinale dhe kopje në fazën e shqyrtimit. Pasi të jenë shqyrtuar kuponët dhe faturat origjinale i kthehen realizuesit të projektit;
 - vi. Kuponët dhe faturat duhet të jenë të listuar në tabelën e shpenzimeve që mund të shkarkohet nga ueb faqja e komunës;
4. Projekti konsiderohet i mbyllur pas pranimit të njoftimit “përmbyllja e projektit” përmes postës elektronike nga zyrtari i DK-së;